



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 87, datë 9.2.2022

P Ë R

PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT/RIPARIMIT TË MJEDISEVE
NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA
(PALLAT), NË BASHKINË MIRDITË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 383 780 091 (treqind e tetëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë, për financimin e rikonstruksionit/riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë.
2. Përdorimin e fondit për vitin 2022 nga Bashkia Mirditë në masën 76 756 018 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëmbëdhjetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit/riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë.
3. Efekti financiar për vitin 2022 të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe t'i transferohet Bashkisë Mirditë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ